VENDIM
Nr. 31, datë 6.7.2022

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA OTP BANK NYRT (HUNGARI) TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS ALPHA ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të shkronjës "gj", të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Alpha Albania sh.a. nga OTP Bank Nyrt (Hungari).
2. Ngarkohet Banka Alpha Albania sh.a. të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përmbushjen e transaksionit të kalimit të aksioneve.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko